



KUFIZIMET PËR PËRDORIMIN E BURIMEVE SHTETËRORE NË FUSHATËN ZGJEDHORE



Veprimtaritë publike promovuese të zyrtarëve qendrorë dhe vendorë



Aktet ligjore që sjellin përfitime elektorale si pagat, rritja e pensionit, amnistia fiskale etj (Neni 91, pika 4)

Projekte dhe/ose të investime të një natyre publike financimi i të cilave përkon me periudhën e fushatës zgjedhore dhe që nuk janë lajmëruar paraprakisht (Neni 92, pika 1)



Shpërndarja publikisht e lejeve të legalizimeve apo çdo lloj titulli pronësie tjetër (Neni 92, pika 1)



Pjesëmarrja në fushatë e administratës shtetërore gjatë orarit të punës dhe përdorimi i detyruar dhe i organizuar i nxënësve të arsimit parauniversitar në aktivitetet e fushatës brenda orarit të mësimin (Neni 91, pika 2)



Punësimi, pushimi nga puna, kontratat e përkohshme ose afatshkurtra të punësimit gjatë fushatës zgjedhore (Neni 91, pika 3)

Premtimi ose ofrimi i përfitimeve për nëpunësit publikë dhe nxënësit e të mirave dhe shërbimeve të blera me fonde publike (Neni 91, pika 2)



Përdorimi i aseteve publike si ambjentet, automjetet, shërbimet publike apo mjetet institucionale të komunikimit (Neni 91, pika 1)


Qytetarë, nëse konstatoni shkeljet e mësipërme mos hezitoni të denonconi pranë **portalit të denoncimeve** të Komisionit Qendror Zgjedhor në adresën <http://kqz.gov.al/kallzo>, nëpërmjet **aplikacionit mobile KQZ** për telefonat smartphone si dhe në ndërfaqen e aktiviteteve të ndaluara <https://aktivitete.kqz.gov.al/raporto>. Ju mund të zgjidhni të mbeten anonim, ndërkohë që denoncimet tuaja do të ndiqen më pas nga organet e drejtësisë, mes të cilave edhe Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (SPAK).



Punonjës publikë, nëse jeni bërë pjesë e presioneve nga drejtuesit apo formave të tjera të nxitjes për të kryer shkeljet e mësipërme, rrezikoni që të ndiqeni penalisht me dënime deri në pesë vite burgim, si dhe humbjen e të drejtës për t'u punësuar në të ardhmen në administratën publike.



Për më shumë informacion kontaktoni: **KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**



Ky material informues u mundësua falë projektit **Forcimi i Transparencës së Zgjedhjeve në Shqipëri (SETA)** i zbatuar nga Akademia e Studimeve Politike me mbështetjen e ambasadës së Mbretërisë së Vendeve të Ulta në Tiranë dhe programit të përbashkët të Këshillit të Evropës dhe Bashkimit Evropian “Veprimi kundër Krimin Ekonomik në Shqipëri”